



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

RAPORTI I PUNËS

Periudha Janar - Gusht 2021

Shtator, 2021

RAPORTI I PUNËS I NJËSISË SË BURIMEVE NJERËZORE, JANAR - GUSHT 2021 - KOMUNA E PODUJEVËS

Data:	07.09.2021
Drejtoria/Spektori/Zyra:	Njësia e Burimeve Njerëzore
Periudha Raportuese:	Janar - Gusht 2021
Raportuesi:	Fitim Bunjaku - Menaxher Personeli
Kryetari i Komunës: Nënkryetarja e Komunës:	Shpejtim Bulliqi Marigona Lahu



1. PËRMBLEDHJE

Gjatë periudhës Janar - Gusht të Vitit 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore krahas sfidave ka arritur edhe në realizimin e shumë aktiviteteve lidhur me fushën e burime njerëzore si: planifikimin, organizmin e rekrutimeve të jashtme dhe të brendshëm të stafit për aq sa i është lejuar ligjërisht (pranimi klasifikimi i aplikacioneve, perpilimi i listës së ngushtë, njoftimi i komisionit, njoftimi i aplikantëve për secilën fazë të rekrutimit, përgatitja e anës teknike dhe këshillimi i komisionit për procedurat e rekrutimit etj.), pushimet online të nëpunësve, përcjelljen çdo muaj të ndryshimeve lidhur me pagat dhe mëditjet e nëpunësve në MF, pranimin dhe përcjelljen e listave të pagave përmes Sistemit të Pagave (PMS), përcjelljen e procedurave të largimit të stafit nga shërbimi civil sipas legjislacionit në fuqi, informimin e mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë lidhur me vlerësimin vjetor të stafit, pranimin e një numri të konsiderueshëm të kërkesave lidhur me dokumentet dhe të dhënat që i posedon Njësia e Burimeve Njerëzore sa i përket stafit aktual dhe ish stafit, lëshimin e vërtetimeve mbi përvojën e punës, punës praktike dhe për çdo çështje tjetër lidhur me fushën e saj, ofrimin e fakteve të kërkuara nga KPMSHCK lidhur me ankesat e palëve, ofrimin e fakteve Komisionit Disiplinor, përcjelljen e procedurave të inicuar dhe pjesëmarrja në komision, ofrimi i fakteve Komisionit të Ankesave, pjesëmarrja në komision, mirëmbajtjen e dosjeve të personelit, përditësimin e bazës së të dhënave lidhur me nëpunësit, ofrimin e qasjeve dhe asistim të nëpunësve/komisioneve në SIMBNJ, përcjelljen e SMVP-ës (sistemin për menaxhimin e vijueshmërisë së personelit), nxjerrjen e vendimeve mbi pensionimet e nëpunësve, nxjerrjen e vendimeve mbi pushimet e

lehonisë, nxjerrjen e vendimeve mbi pushimet pa pagesë, përgatitjen e vendimeve mbi shtesat në pagë, propozimi dhe përgatitjen e vendimeve për komisionet përzgjedhëse të rekrutimit, përcjelljen e agjendave të trajnimeve kryesisht nga IKAP tek stafi përkatës etj.

Stafi i kësaj zyre përkundër faktit që ka punuar me staf esencial (për shkak të Pandemisë) dhe realisht është i pamjaftueshëm, krahas aspektit të gjerë të punëve, i është përgjigjur të gjitha kërkesave në kompetencën e saj dhe ka qenë bashkëpunues me komisionet dhe stafin tjetër të institucionit.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Përpilimi i Planit të Personelit për Vitin 2021 për Nëpunësit Civil në SIMBNJ;
- Përpilimi i Planit Vjetor të Trajnimeve për Nëpunësit Civil për Vitin 2021;
- Raporti i Vlerësimeve të nëpunësve për vitin paraprak;
- Raporti i Statistikave për vitin paraprak në SIMBNJ;
- Shpallja e 20 konkurseve për pozitat e lira si shërbyes civil përmes sistemit HRMIS me procedurën **Lëvizje Paralele**;
- Shpallja e 2 konkurseve për pozitat e lira si shërbyes civil përmes sistemit HRMIS me procedurën e **Avancimit**
- Shpallja e 1 konkursi për pozitën e lirë si shërbyes civil përmes sistemit HRMIS me procedurën e **Pranimit**;
- Rekrutimin e 4 pozitave të nëpunësve të shërbimeve publike në Komunë;
- Shpalljen e 16 konkurseve të jashtme në QKMF për gjithsej 30 pozita;
- Rekrutimin e 24 pozitave të nëpunësve të QKMF-së;
- Implementimin e Pushimeve në SIMBNJ sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- Mbajtja e Trajnimeve në numër të vogël nga IKAP, pjesa dërmuese në formën ONLINE;
- Fillimi i implementimit gradualisht të aplikacionit HRMIS;
- Fillimi i implementimit të Portalit për Publikime të Konkurseve për Zyrtarët Publikë;
- Përditësimi i të dhënave të nëpunësve në SIMBNJ;
- Mbajtja dhe përditësimi i listës dhe informimi i Zyrtarëve të Lartë Publik lidhur me Deklarimin e Pasurisë në Agjencionin Kundër Korrupsionit;

-Aktivitetet rutinore të Zyrës: Pranimi, shpërndarja për nënshkrime e listës mujore të pagave, regjistrimi i pushimeve vjetore, mjekësore, të lehonise, nxjerrja e vërtetimave mbi përvojën e punës së në punësve dhe ish nëpunësve, përgatitja e vendimeve, akt emërimeve, kontratave të punës, njoftimeve te ndryshme, raporteve etj.

3.STATISTIKAT

-Nëpunës në Komunën e Podujevës në Gusht 2021 janë gjithësej **259**, prej të cilëve **256** të nacionalitetit Shqiptarë, **1** serb dhe **2** Ashkali.

-Nga **259** në punës **178** nëpunës jane meshkuj dhe **81** femra

-Nga **259** nëpunës **178** janë nëpunës të shërbimit civil, **12** janë nëpunës të shërbimit publik, **18** staf politik/nëpunë të kabinetit, **51** staf mbështetës.

-Përgjatë periudhës Janar - Gusht 2021 janë larguar nga Komuna e Podujevës **8 nëpunës**, prej të cilëve pesë (5) me Pensionim të Rregullt, dy (2) nëpunës kanë dhënë dorëheqje dhe një (1) nëpunëse është transferuar në institucion tjetër.

-Rekrutime për nëpunës civil brenda kësaj periudhe nuk ka pasë për shkak se nuk ka pasë aplikantë të brendshëm që i plotësojnë kriteret dhe për shkak të kufizimeve dhe pa mundësisë teknike me ndryshimin e legjislacionit për vazhdimin e rekrutimeve te jashtme.

-Rekrutime si nëpunës të shërbimit publik/nëpunës mbështetës kanë qenë 4 (Drejtor i Teatrit të Qytetit, 2 Roje Pylli dhe 1 Roje Objekti).

-Gjatë periudhës Janar - Gusht 2021 janë bërë 16 transfere prej të cilave 15 transfere të përkohshme të brendshme dhe 1 transfer i përhershëm i jashtëm.

-Masa disiplinore janë ndërmarrë për 7 nëpunës nga të cilat 7 kanë qenë Vërejtje me shkrim.

-Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës kanë qenë 6.

-Ankesa në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik kanë qenë 5.

4.SFIDAT

Gjatë 8 mujorit të Vitit 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore ka hasë në vështirësi të shumta me Legjislacionin dhe mungesën e Akteve nënligjore në zhvillimin e shumë procedurave e me theks të veçantë në implementimin e Planit të Rekrutimit.

Hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publikë ka penguar zhvillimin e procedurave duke pasë mungesë të Akteve nënligjore, të sqarimeve, të trajnimeve, të anës teknike etj. Gjendje kjo, e cila vazhdon edhe sot e tutje.

Ndër të tjera edhe masat e marra vazhdimisht nga Qeveria lidhur me Pandeminë dhe infektimi i personelit, kanë ndikuar që Institucioni në përgjithësi të punojë me staf esencial dhe me shërbime esenciale, duke e kufizuar kështu në masë të madhe zhvillimin e aktiviteteve drejt arritjes së objektivave.

Për shumicën e kërkesave/sqarimeve të dërguara në DMZP-së nuk kemi marrë asnjë përgjigje, ose përgjigje të mangëta, ndër to dhe kërkesa për përmirësimin e koeficientëve të nëpunësve civil të cilët përkunder mundësive dhe planifikimeve buxhetore nuk paguhen konform gradës që e kanë duke u dëmtuar për kohë të gjatë materialisht.

Mungesa e kompetencave për ndërhyrje në SIMBNJ dhe në HRMIS (sistemi i ri) dhe ndryshimi i tij varësisht prej legjislacionit, ka paraqitur shpesh pengesa dhe vonesa në zhvillimin e procedurave të cilat duhet kryer përmes tij (procedurat e rekrutimit, pushimet online, probleme në krijimin e qasjeve për nëpunësit etj).

5.REKOMANDIME

Njësia e Burimeve Njerëzore rekomandon që të gjitha kërkesat e drejtuara drejt saj të bëhen në mbështetje të ligjeve/rregulloreve të reja në fuqi dhe brenda afateve kohore.

Të krijohen kushtet teknike për implementimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e rekrutimit bazuar në rekomandimet e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe akteve nënligjore.

Bazuar në mundësitë buxhetore konsiderohet e nevojshme që në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit të merret për bazë çështja e rregullimit të koeficientëve të nëpunësve konform gradës së pozitës së punës.